



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Metodologjia ZRRE/Nr.01 /2023

METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E PREMIUMIT TË FIKSUAR MAKSIMAL, ÇMIMIT TË FIKSUAR MAKSIMAL DHE TARIFËS NXITËSE MAKSIMALE

13 dhjetor 2023

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, bazuar në Nenin 9, paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, neni 15, neni 26, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë nr. 05/L-084, Nenin 8 paragrafi 9 të Ligjit për Energjinë Elektrike nr. 05/L-085 dhe Nenin 9 par.6 të Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2023 për promovimin e Shfrytëzimit të Energjisë nga Burimet e Ripërtitshme, në seancën e mbajtur më 13 dhjetor 2023 miratoi:

METODOLOGJIA PËR PËRCAKTIMIN E PREMIUMIT TË FIKSUAR MAKSIMAL, ÇMIMIT TË FIKSUAR MAKSIMAL DHE TARIFËS NXITËSE MAKSIMALE

KAPITULLI I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo metodologji përcakton parimet për llogaritjen e Premiumit të Fiksuar Maksimal, Çmimit të Fiksuar Maksimal dhe Tarifës Nxitëse Maksimale për skemat mbështetëse për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtitshme të energjisë, të zbatuara përmes një procesi të tenderimit konkurrues.
2. Kjo metodologji përcakton:
 - 2.1. Parimet bazë sipas të cilave do të llogaritet për Premiumi i Fiksuar Maksimal, Çmimi i Fiksuar Maksimal dhe Tarifa Nxitëse Maksimale; dhe,
 - 2.2. Metodën për llogaritjen për Premiumit të Fiksuar Maksimal, Çmimit të Fiksuar Maksimal dhe Tarifës Nxitëse Maksimale.

Neni 2

Përkufizimet dhe interpretimet

1. Termat e përdorur në këtë metodologji kanë kuptimin e mëposhtëm:
 - 1.1. **Burimet e Ripërtitshme te Energjise** - nënkupton Burimet jo-fosile, përkatësisht era, dielli (solare termike dhe solare fotovoltaike) dhe energjia gjeotermike, Energjia Ambientale, baticat, valët dhe energji tjetër nga oqeani, hidroenergja, biomasa, gazi nga deponitë, gazi nga impiantet e trajtimit të ujërave të zeza dhe biogazi;
 - 1.2. **Çmimi i Fiksuar** – nënkupton çmimin përfundimtar që do të përfitojë Prodhuesi i Privilegjuar i energjisë elektrike, si rezultat i dhënies nga një Proces Konkurrues i Tenderimit;
 - 1.3. **Çmimi i Fiksuar Maksimal** – nënkupton çmimin maksimal që mund t'i ndahet një Prodhuesi të Privilegjuar të energjisë elektrike përmes procesit të ofertimit konkurrues;
 - 1.4. **Çmimi i Tregut të Organizuar**– nënkupton çmimin i cili përcaktohet në tregjet e organizuara si rezultat i ofertës dhe kërkesës;

- 1.5. **Çmimi Referent i Tregut** – nënkupton çmimin për orë i vendosur në Tregun e Organizuar të Kosovës një ditë përpara me të cilin operon Bursa Shqiptare e Energjisë. Nëse Çmimi i Tregut të Organizuar në Kosovë një ditë përpara nuk mund të përcaktohet, Çmimi Referent i Tregut do të përcaktohet nga Rregullatori, përmes akteve nënligjore bazuar në metodologjinë për caktimin e Çmimit Referent. Në rast se Çmimi Referent është negativ, ai do të konsiderohet zero për qëllime të barazimit financiar sipas një kontrate për diferencë;
- 1.6. **Çmimi Referent i Tregut i Përcaktuar nga Rregullatori** – është çmimi referent i llogaritur në bazë të Metodologjisë për Llogaritjen e Çmimit Referent për Energjinë e Prodhuar nga BRE” nr. 01/2020.
- 1.7. **Kontrata për Diferencë** – nënkupton një lloj Kontrate për Mbështetje të barazuar financiarisht ku një premium rrëshqitës, i përbërë nga ndryshimi midis Çmimit Referent dhe Çmimit të Fiksuar, barazohet ndërmjet Operatorit të Energjisë së Ripërtërishme dhe Prodhuesit të Privilegjuar. Nëse Çmimi Referent është më i ulët se Çmimi Fiksuar, Operatori i Energjisë së Ripërtërishme i paguan ndryshimin Prodhuesit të Privilegjuar. Nëse Çmimi Referent është më i lartë se Çmimi Fiksuar, Prodhuesi i Privilegjuar i paguan ndryshimin Operatorin për Energjinë e Ripërtërishme.
- 1.8. **Kontrata për Mbështetje** – nënkupton kontratën në bazë të së cilës Prodhuesit të Privilegjuar i jepet mbështetje sipas një Skeme Mbështetëse në formën e një MBE-je, një Kontrate për Premium ose një Kontratë të Diferencës apo Tarifë nxitëse. Një model për çdo lloj Kontrate për Mbështetje hartohet nga Operatori i Energjisë së Ripërtërishme dhe publikohet pas miratimit nga Rregullatori;
- 1.9. **Kontrata për Premium** – nënkupton lloj të mbështetjes përmes barazimit financiar ku një premium fiks mbi çmimin e tregut paguhet nga Operatori i Energjisë së Ripërtërishme për Prodhuesin e Privilegjuar për energjinë elektrike të prodhuar nga Prodhuesi i Privilegjuar.
- 1.10. **Marrëveshja e Blerjes së Energjisë Elektrike (MBE)** – nënkupton një lloj Kontrate për Mbështetje të barazuar fizikisht, ku Operatori i Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme si marrës i caktuar garanton blerjen e detyrueshme të energjisë elektrike të prodhuar nga Prodhuesi i Privilegjuar me një çmim të paracaktuar;
- 1.11. **Operator i Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme** - nënkupton subjektin e caktuar për të qenë palë homologe e Prodhuesve të Energjisë së Ripërtërishme që përfitojnë nga Skema Mbështetëse dhe është përgjegjës për menaxhimin e Fondit Mbështetës për Energjinë e Ripërtërishme;
- 1.12. **Premiumi i fiksuar maksimal** – nënkupton shumën maksimale fikse mbi çmimin e tregut të një dite para që mund t'i ndahet një Prodhuesi të Privilegjuar përmes procesit të ofertimit konkurrues në bazë të një Kontrate për Premiumin;
- 1.13. **Premiumi rrëshqitës** – nënkupton diferencën ndërmjet çmimit të garantuar të blerjes dhe çmimit me të cilin Prodhuesi i Privilegjuar ka shitur energjinë elektrike të prodhuar në bursën lokale;

- 1.14. **Procesi i tenderit konkurrues** - nënkupton një proces tenderimi transparent, jodiskriminues që parashikon pjesëmarrjen e një numri të mjaftueshëm kompanish dhe ku mbështetja financiare ndahet në bazë të ofertave më të suksesshme të paraqitura nga ofertuesit në një proces konkurrues;
 - 1.15. **Prodhues i Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme** – nënkupton personin fizik ose juridik që prodhon energji nga Burimet e Ripërtërishme të energjisë;
 - 1.16. **Prodhues i Privilegjuar** - nënkupton çdo prodhues të energjisë së ripërtërishme që përfiton nga një skemë mbështetëse;
 - 1.17. **Rregullator** – nënkupton Zyrën e Rregullatorit për Energji të Republikës së Kosovës, e themeluar si agjenci e pavarur sipas Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
 - 1.18. **Skema Mbështetëse** - nënkupton secilin instrument, skemë apo mekanizëm të aplikuar nga Republika e Kosovës, që promovon përdorimin e energjisë nga Burimet e Ripërtërishme duke ulur koston e asaj energjie, duke garantuar çmimin me të cilin mund të shitet , ose duke rritur vëllimin e kësaj energjie të blerë, duke përfshirë, por pa u kufizuar në to, ndihmën në investime, lirimet apo zbritjet tatimore, rimbursimet tatimore, si dhe skemat e mbështetjes direkte të çmimeve, duke përfshirë tarifatat nxitëse dhe pagesat rrëshqitëse ose fikse të premieeve;
 - 1.19. **Tarifa nxitëse maksimale** - nënkupton çmimin maksimal të garantuar që mund t'i ndahet një Prodhuesi të Privilegjuar përmes procesit të ofertimit konkurrues me një tarifë nxitëse.
2. Termat e tjerë të përdorur në këtë Rregull kanë kuptimin e njëjtë me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, Ligjin për Energjinë, Ligjin për Energjinë Elektrike dhe ligjet tjera të aplikueshme në Kosovë.

Neni 3

Parimet kryesore

1. Rregullatori do të caktojë parimet për Premiumin e Fiksuar Maksimal, Çmimin e Fiksuar Maksimal dhe Tarifën Nxitëse Maksimale në Proces të Ofertimit Konkurrues.
 - 1.1. Premiumi i fiksuar maksimal përdoret kur Procesi i Ofertimit Konkurrues shfrytëzon një kontratë për premium, përmes një premium të fiksuar.
 - 1.2. Çmimi i fiksuar maksimal përdoret kur Procesi i Ofertimit Konkurrues shfrytëzon një kontratë për Çmim të Fiksuar Maksimal.
 - 1.3. Tarifa nxitëse maksimale përdoret kur Procesi i Ofertimit Konkurrues përdor një mekanizëm të tarifës nxitëse.
 - 1.4. Ofertat që tejkalojnë Premiumin e Fiksuar Maksimal, Çmimin e Fiksuar Maksimal dhe Tarifën Nxitëse Maksimale do të përjashtohen nga procesi i ofertimit konkurrues.

2. Rregullatori do të synoj të vendos Premiumin e Fiksuar Maksimal, Çmimin e Fiksuar Maksimal dhe Tarifën Nxitëse Maximale në një nivel që lejon konkurrencë të mjaftueshme brenda Procesit të Ofertimit Konkurrues dhe kufizon përfitimet e tepruara të Prodhuesit të Privilegjuar duke siguruar se mund të kontraktohet kapaciteti i mjaftueshëm.
3. Rregullatori do të marrë parasysh kohëzgjatjen e Kontratave për Mbështetje, të përcaktuara për ankandin specifik, për të vendosur Premiumin e Fiksuar Maksimal, Çmimin e Fiksuar Maksimal dhe Tarifën Nxitëse Maximale.
4. Në përcaktimin e Premiumit të Fiksuar Maksimal, Çmimit të Fiksuar Maksimal dhe Tarifës Nxitëse Maximale, Rregullatori do t'i referohet, por nuk është i obliguar ose i kufizuar nga:
 - 4.1. Të dhëna e nevojshme për vlerësimin e çmimit për procesin përkatës;
 - 4.2. Vëllimet dhe kostot e mëhershme nga projektet e mëparshme të ngjashme të energjisë së ripërtëritshme dhe skemat mbështetëse në Kosovë dhe vende të tjera në Evropë, duke marrë parasysh ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet projekteve;
 - 4.3. Rezultatet nga skemat e mëparshme të mbështetjes për energjinë e ripërtëritshme;
 - 4.4. Të dhënat historike për tregun e energjisë elektrike në Kosovë dhe në vende të tjera në Evropë;
 - 4.5. Projeksionet e ardhshme të tregut të energjisë elektrike në Kosovë dhe vende të tjera në Evropë; dhe
 - 4.6. Të dhënat dhe llogaritjet e ndonjë projekti specifik.

Neni 4

Alternativat për të analizuar dhe vendosur Premiumin e Fiksuar Maksimal, Çmimin e Fiksuar Maksimal dhe Tarifën Nxitëse Maximale

1. Rregullatori mund të përdorë, por nuk kufizohet në, një ose një kombinim të alternativave të mëposhtme për të vendosur Premiumin e Fiksuar Maksimal, Çmimin e Fiksuar Maksimal dhe Tarifën Nxitëse Maximale:
 - 1.1. Vendosjen e Premiumit të Fiksuar Maksimal, Çmimin e Fiksuar Maksimal dhe Tarifën Nxitëse Maximale përmes Çmimit Referent të Përcaktuar nga Rregullatori;
 - 1.2. Vendosjen e Premiumit të Fiksuar Maksimal, Çmimin e Fiksuar Maksimal dhe Tarifën Nxitëse Maximale duke përdorur çmimin e përcaktuar përmes Procesit të mëparshëm të Ofertimit Konkurrues për të njëjtën teknologji të burimeve të ripërtëritshme; dhe,
 - 1.3. Vendosjen e Premiumit të Fiksuar Maksimal, Çmimin e Fiksuar Maksimal dhe Tarifën Nxitëse Maximale përmes Metodologjisë së Kostos së Niveluar të Energjisë Elektrike (LCOE).

2. ZRRE-ja mund të përshtas Premiumin e Fiksuar Maksimal, Çmimin e Fiksuar Maksimal dhe Tarifën Nxitëse Maximale që rezultojn nga alternativat e përmendura në nenin 4, paragrafi 1, bazuar në rezultatet nga projekti i mëparshëm i Skemave Mbështetëse, njohurive të ekspertëve dhe përvojës rajonale.

Neni 5

Përcaktimi i Premiumit të Fiksuar Maksimal, Çmimit të Fiksuar Maksimal dhe Tarifës Nxitëse Maximale sipas Çmimit Referent të Tregut të Përcaktuar nga Rregullatori

1. Premiumi i Fiksuar Maksimal, Çmimi i Fiksuar Maksimal dhe Tarifa Nxitëse Maximale të vendosura në Çmimin Referent të përcaktuar nga Rregullatori marrin në konsideratë të dhënat nga e kaluara, për të vlerësuar kostot e shmangura që rezultojnë nga një projekt.
 - 1.1. Rregullatori do të përdorë “Metodologjinë për Llogaritjen e Çmimit Referent për Energjinë e Prodhuar nga BRE-të” nr. 01/2020, për të vendosur Premiumin e Fiksuar Maksimal, Çmimin e Fiksuar Maksimal dhe Tarifën Nxitëse Maximale përmes kësaj alternative.
 - 1.2. Rregullatori mund të përdorë të dhëna nga viti paraprak ose mesataren e shumë viteve të kaluara për vlerësimin e çmimit referent sipas këtij neni.
 - 1.3. Për skemat konkurruese me teknologji specifike, Rregullatori mund të përdor profilet e prodhimit të energjisë për projektin specifik në baza ore. Prodhimi i energjisë elektrike do të marrë parasysh të gjitha humbjet deri në pikën e matjes.
 - 1.4. Për skemat konkurruese neutrale ndaj teknologjisë, Rregullatori do të përdorë çmimet mesatare referente historike të tregut në baza vjetore.
2. Premiumi i fiksuar maksimal i vendosur me anë të kësaj alternative vendoset në 0 (zero), pasi që Çmimi Referent paraqet çmimin e zhvendosur të tregut sipas bazës meritore.

Neni 6

Përcaktimi i Premiumit të Fiksuar Maksimal, Çmimit të Fiksuar Maksimal dhe Tarifës Nxitëse Maximale duke përdorur çmimin e përcaktuar në Procesin e mëparshëm të Ofertimit Konkurrues

1. Rregullatori mund të përdorë këtë alternativë kur kushtet e Procesit aktual të Ofertimit Konkurrues nuk ndryshojnë ndjeshëm nga Procesin e mëparshëm të Ofertimit Konkurrues. Kjo përfshinë:
 - 1.1. Teknologji të ngjashme të Procesit të Ofertimit Konkurrues;
 - 1.2. Kontributet nga Qeveria e Kosovës (si shfrytëzimi i tokës, kyçja në rrjet etj.);
 - 1.3. Kohëzgjatja e kontratave për mbështetje;
 - 1.4. Pronësia e stabilimentit pas përfundimit të Kontratës për Mbështetje;
 - 1.5. Madhësia dhe kompleksiteti i projektit;

- 1.6. Kushtet gjeografike dhe moti;
- 1.7. Kostoja e teknologjisë, materialeve dhe punës.
2. Rregullatori do të përdorë çmimin e vendosur në Procesin e mëparshëm të Ofertimit Konkurrues, me një mbi-kapacitet prej të paktën 50% të kapacitetit të synuar të Procesit të mëparshëm të Ofertimit Konkurrues.
 - 2.1. Nëse Procesi i mëparshëm i Ofertimit Konkurrues nuk ka rezultuar në një mbi-kapacitet prej 50%, atëherë Rregullatori mund të përdorë Premiumin e Fiksuar Maksimal, Çmimin e Fiksuar Maksimal dhe Tarifën Nxitëse Maksimale të procesit më të fundit Konkurrues që plotëson këtë kusht.

Neni 7

Përcaktimi i Premiumit të Fiksuar Maksimal, Çmimit të Fiksuar Maksimal dhe Tarifës Nxitëse Maksimale përmes Metodologjisë së Kostos së Nivelizuar të Energjisë Elektrike (Levelized Cost of Electricity - LCOE)

1. Rregullatori përmes kësaj alternative do të vlerësojë të gjitha kostot e aplikueshme për projektin e planifikuar, periudhën e ndërtimit dhe kohëzgjatjen e Kontratës për Mbështetje të projektit. Kjo mund të përfshijë, por nuk kufizohet në:
 - 1.1. Kostot e teknologjisë;
 - 1.2. Kostot e operimit dhe mirëmbajtjes;
 - 1.3. Kostot e inxhinierisë, prokurimit dhe ndërtimit (përfshirë kostot e transportit të teknologjisë);
 - 1.4. Kostot e kyçjes në rrjet dhe tarifatat për përdorimin e rrjetit;
 - 1.5. Kthimin e arsyeshëm në investim, duke marrë parasysh nivelin e riskut;
 - 1.6. Kostot e financimit dhe kostot kapitale (borxhi, ekuiteti);
 - 1.7. Kostot e aplikueshme të balancimit;
 - 1.8. Kostoja e tokës;
 - 1.9. Kostot e dekomisionimit (nëse është e aplikueshme); dhe,
 - 1.10. Të gjitha tarifatat, ngarkesat dhe taksat e aplikueshme.
2. Rregullatori mund të bazojë vlerësimin e tij në të dhënat nga projektet e ngjashme të zbatuara.
3. Prodhimi i energjisë elektrike do të marrë parasysh të gjitha humbjet deri në pikën e matjes.
4. Kohëzgjatja e Kontratës për Mbështetje nga Procesi specifik i Ofertimit Konkurrues, do të konsiderohet si jetëgjatësia e projektit për të vendosur Premiumin e Fiksuar Maksimal, Çmimin e Fiksuar Maksimal dhe Tarifën Nxitëse Maksimale përmes alternativës LCOE.

5. Premiumi i fiksuar maksimal i vendosur me alternativën e Kostos së Nivelizuar të Energjisë, do të vlerësoj të gjitha kostot e aplikueshme për projektin, dhe do të përjashtojë të hyrat e parashikuara financiare për energjinë elektrike të shitur nga prodhuesi në treg.
 - 5.1. Rregullatori mund të përdorë parashikimet ose të dhënat nga e kaluara mbi çmimet e tregut për të vlerësuar të hyrat e parashikuara nga energjia elektrike e shitur në treg.
6. Çmimi i Fiksuar Maksimal dhe Tarifa Nxitëse Maximale do të vendosen në LCOE që rezulton nga kjo llogaritje.
7. Metoda për llogaritjen e Premiumit të Fiksuar Maksimal, Çmimit të Fiksuar Maksimal dhe Tarifës Nxitëse Maximale përmes metodës LCOE, pershkruhet në nenin 8.

KAPITULLI II

METODOLOGJIA PËR LLOGARITJEN E PREMIUMIT TË FIKSUAR MAKSIMAL DHE ÇMIMIT TË FIKSUAR MAKSIMAL

Neni 8

Metoda e llogaritjes përmes Metodologjisë së Kostos së Nivelizuar të Energjisë Elektrike (LCOE)

1. Premiumi i fiksuar maksimal i vendosur përmes alternativës LCOE zbaton ekuacionin e mëposhtëm:

$$\text{Premiumi i fiksuar maksimal} = LCOE_p$$

$$LCOE_p = \frac{\text{Kostoja totale e projektit} - \text{Te hyrat nga tregu}}{\text{Prodhimi (outputi) total i projektit}}$$

$$\text{Kostoja totale e projektit} = \sum_{t=1}^n \frac{C_t}{(1+r)^t}$$

$$\text{Te hyrat nga tregu} = \sum_{t=1}^n \frac{P_t \times E_t}{(1+r)^t}$$

$$\text{Prodhimi total i projektit} = \sum_{t=1}^n \frac{E_t}{(1+r)^t}$$

$$LCOE_p = \frac{\sum_{t=1}^n \frac{C_t - (P_t \times E_t)}{(1+r)^t}}{\sum_{t=1}^n \frac{E_t}{(1+r)^t}}$$

Ku:

$LCOE_p$	Kostoja e Nivelizuar e Energjisë Elektrike, për të vendosur premiumin e fiksuar maksimal;
C_t	Kostot/shpenzimet në vitin t (përfshirë, por pa u kufizuar në shpenzimet e përmendura në nenin 6, paragrafi 1 të kësaj metodologjie), të bëra gjatë ndërtimit dhe gjatë periudhës së Kontratës për Mbështetje;
E_t	Energjia elektrike e prodhuar në pikën e matjes në vitin t,;
P_t	Çmimi mesatar i vlerësuar i energjisë elektrike në treg, në vitin t;
r	Norma e zbritjes;
n	Kohëzgjatja e Kontratës për Mbështetje, e caktuar për ankandin specifik.

2. Çmimi i Fiksuar Maksimal dhe Tarifa Nxitëse Maximale, të vendosura sipas alternativës LCOE, zbaton ekuacionin e mëposhtëm:

Çmimi maksimal nxitës/fiksuar = $LCOE_S$

$$LCOE_S = \frac{\text{Kostoja totale e projektit}}{\text{Prodhimi total i projektit}}$$

$$\text{Kostoja totale} = \sum_{t=1}^n \frac{C_t}{(1+r)^t}$$

$$\text{Prodhimi total} = \sum_{t=1}^n \frac{E_t}{(1+r)^t}$$

$$LCOE_S = \frac{\sum_{t=1}^n \frac{I_t + O_t + \dots}{(1+r)^t}}{\sum_{t=1}^n \frac{E_t}{(1+r)^t}}$$

Ku:

$LCOE_S$ Kostoja e Nivelizuar e Energjisë Elektrike për të vendosur tarifën nxitëse maksimale/çmimin e fiksuar maksimal;

C_t Kostot/shpenzimet në vitin t (përfshirë, por pa u kufizuar në, shpenzimet e përmendura në nenin 6, paragrafi 1 të kësaj metodologjie), të bëra gjatë ndërtimit dhe gjatë periudhës së Kontratës për Mbështetje;

E_t Energjia elektrike e prodhuar në pikën e matjes në vitin t;

r Norma e zbritjes;

n Kohëzgjatja e Kontratës për Mbështetje e caktuar për ankandin specifik.

KAPITULLI V DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 9 Modifikimi

1. Rregullatori ka të drejtë të ndryshojë ose modifikojë çdo dispozitë të kësaj Metodologji.
2. Procedurat për ndryshimin ose modifikimin e kësaj Metodologji do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.

Neni 10 Interpretimi

Në rast se ka paqartësi në lidhje me dispozitat e kësaj Metodologji, Bordi do të lëshoj interpretime shpjeguese.


Neni 11 Hyrja në fuqi

Kjo Metodologji hyn në fuqi pas miratimit nga Bordi i Rregullatorit për Energji dhe do të publikohet në faqen zyrtare elektronike të Rregullatorit.


Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Lutfije Dervishi, anëtare


Gadiu Buçaj, anëtar


Arta Isufi, anëtare


Adrian Preniqi, anëtar